



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.986/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “N...T...” Sh.P.K., me numër unik identifikues ... dhe seli në Istog, rr. “...”, p.nr., kundër debitorit “F...P...” Sh.P.K., me numër unik identifikues dhe seli në Prishtinë, rr. “...”, p.nr., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 203/2021, i lejuar me datë 28.05.2021, nga Përbaruesi Privat Fatos Shatri, me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 15.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “F...P...” Sh.P.K., me numër unik identifikues, i ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 203/2021, i lejuar me datë 28.05.2021, nga Përbaruesi Privat Fatos Shatri.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 203/2021, i lejuar me datë 28.05.2021, nga Përbaruesi Privat Fatos Shatri, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “N...T...” Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm, faturës nr. 08-09-FCP, të datës 08.09.2020, ka lejuar urdhrin përbarimor P.nr. 203/2021, të datës 28.05.2021, me të cilin është detyruar debitori “F...P...”, Sh.P.K., që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin përbarimor, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 4,033.00, ne emër të përmbushjes së faturës, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar urdhrin përbarimorë me arsyetim se dokumenti, përkatësisht fatura mbi bazën e së cilit është lejuar

urdhri përmbartimor nuk ka tipare të përmbartueshmërisë ngase nuk është lëshuar si faturë e rregullt dhe i mungon vula e debitorit, ndërsa gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i paraqitur nga debitori është i pabazuar, ngase fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor është e nënshkruar dhe se debitori as në prapësim nuk e ka kontestuar borxhin që rrjedh nga fatura, mirëpo vetëm faktin se fatura nuk është e vulosur nga debitori. Tutje, ka shtuar se fatura i plotëson kushtet e kërkuara për përmbartim, ndërsa gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm mbi bazën e së cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Në anën tjetër paragrafi 3, i nenit 29 të LPP-së, përcakton se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Poashtu, neni 37 të LPP-së, përcakton se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht Faturën nr. 08-09-FCP, e datës 08.09.2020, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, ngase në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar shërbimet me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Gjithashtu, faturat mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor është lëshuar me rregull nga ana

e kreditorit dhe e njëjta është pranuar nga debitori, çka vërtetohet me vënien e nënshkrimit të debitorit.

Vec këtyre, gjykata gjen se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi i është bashkangjitur në origjinal propozimit për përmbarim, ashtu siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e debitorit i cili në prapësim ka theksuar fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson elementet e kërkuara ligjore për shkak se nuk përmban vulën e debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo, për faktin se debitori faturën e ka pranuar dhe e ka nënshkruar, ashtu që ka qenë i njoftuar me detyrimin që rrjedh nga kjo faturë, ndërsa mungesa e vulës nuk e bën të njëjtën të papërmbarueshme. Rrjedhimisht, fatura si e tillë, i përmban te gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm konform LPP-së.

Përfundimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 986/22, datë 15.03.2023

Gjyqtari

Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.